

**VENDIM**  
**Nr. 48, datë 23.1.2013**

**PËR KRIJIMIN E UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË (UMT)<sup>1</sup>**  
*(Ndryshuar me VKM nr.177, datë 6.03.2013; nr.410, datë 18.04.2013)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 9, 12,12/1, 41, 76 e 77, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**I. Krijimi dhe misioni i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT)**

1. Krijohet Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (në vijim UMT), si institucion publik i arsimit të lartë.

2. UMT-ja ka për mision:

a) ofrimin e formimit universitar të studentëve dhe specialistëve në të tria ciklet e studimeve në shkencat e shëndetit;

b) ofrimin e kualifikimit të specialistëve në fushën e shëndetit;

c) thellimin e kualifikimit të punonjësve akademikë e shkencorë universitarë;

ç) kryerjen e kërkimit shkencor bazë dhe të aplikuar;

d) realizimin e funksioneve diagnostikuese e trajtuese themelore, në nivel të lartë shkencor, nëpërmjet shërbimeve, që janë njësi bazë të universitetit dhe pjesë përbërëse e strukturës së qendrave spitalore universitare.

3. Nga Universiteti i Tiranës shkëputen dhe integrohen në strukturën e UMT-së njësitë kryesore të mëposhtme:

a) Fakulteti i Mjekësisë;

b) Fakulteti i Infermierisë.

**II. Struktura e UMT-së**

Në strukturën e UMT-së përfshihen njësitë kryesore, si më poshtë vijon:

a) Fakulteti i Mjekësisë;

b) Fakulteti i Mjekësisë Dentare;

c) Fakulteti i Farmacisë;

ç) Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;

d) Fakulteti i Shëndetit Publik.

**III. Programet e studimeve të UMT-së**

UMT-ja ofron të gjitha programet e studimeve universitare në të tria ciklet e studimit që ka ofruar deri tani Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Infermierisë, i Universitetit të Tiranës, dhe çdo program tjetër, të miratuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

---

<sup>1</sup> VKM nr.48, datë 23.01.2013 është botuar ne Fletoren Zyrtare nr.6/2013.

VKM nr.177, datë 6.03.2013 është botuar ne Fletoren Zyrtare nr.49/2013.

VKM nr.410, datë 18.04.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.87/2013.

#### IV. Organet dhe autoritetet drejtuese të UMT -së

1. Organet dhe autoritetet drejtuese të zgjedhura për strukturat e Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Infermierisë, të Universitetit të Tiranës, vazhdojnë mandatet e tyre në organet dhe autoritetet drejtuese të njërive të reja kryesore të UMT-së, në të cilat janë përfshirë njësitë bazë, ku ata janë zgjedhur. Në organet kolegjiale drejtuese të Fakultetit të Shëndetit Publik marrin pjesë edhe përfaqësues të Institutit të Shëndetit Publik, sipas përcaktimeve të statutit të universitetit dhe rregullores së fakultetit.

2. Autoritetet drejtuese të UMT-së janë:

- a) rektori;
- b) dekanët e fakulteteve;
- c) përgjegjësit e departamenteve.

3. Rektori emërohet sipas pikës 2 të nenit 23 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Organet dhe autoritetet drejtuese të zgjedhura të strukturave ekzistuese funksionojnë në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me statutin e UMT-së.

5. Autoritetet dhe organet e tjera drejtuese emërohen dhe funksionojnë në përputhje me nenin 23 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

*Përbërja e organeve kolegjiale drejtuese, si: Senati Akademik dhe Këshilli i Administrimit (KADM) të Universitetit të Mjekësisë Tiranë, deri në shpalljen e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet kolegjiale drejtuese të këtij universiteti do të jetë si më poshtë vijon:*

*a) Senati Akademik i UMT-së përbëhet nga: anëtarët e zgjedhur të personelit akademik të njërive kryesore ekzistuese, të ish-Fakultetit të Mjekësisë dhe të ish-Fakultetit të Infermierisë në UT; 1 (një) përfaqësues i stafit joakademik të universitetit të caktuar nga rektori; 2 (dy) përfaqësues të studentëve, që janë kryetarët e qeverisë studentore të fakulteteve; autoritetet drejtuese të të tria njërive të reja kryesore dhe nga 2 (dy) përfaqësues të personelit akademik për secilën njësi kryesore të re. Përfaqësuesit e personelit akademik të njërive të reja kryesore caktohen nga këshilli i fakultetit.*

*b) KADM-ja i UMT-së përbëhet nga: anëtarët e zgjedhur të personelit akademik të njërive kryesore ekzistuese, Fakultetit të Mjekësisë dhe të Fakultetit të Infermierisë; 1 (një) përfaqësues nga personeli akademik, i zgjedhur nga këshilli i fakultetit, për secilën prej tri njërive të reja kryesore; 1 (një) përfaqësues të studentëve të zgjedhur nga fakulteti me numrin më të madh të studentëve. Numri i anëtarëve të caktuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës është një më pak se gjysma e numrit të anëtarëve të KADM-së.*

#### V. Organika dhe financimi:

1. Organika e UMT-së përmban numrin e punonjësve të Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Infermierisë që integrohen në të dhe që janë përfshirë në numrin total të punonjësve për Universitetin e Tiranës, nga i cili shpërbëhen njësitë kryesore të sipërpërmendura.

*1/1. Personeli i kualifikuar i qendrave spitalore universitare bëhet pjesë e organikës së personelit akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, sipas njërive kryesore dhe atyre bazë. Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë personeli i kualifikuar janë:*

*a) Rezultate të shkëlqyera (notë mesatare mbi 9) në studimet universitare, në studimet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë dhe titulli “Doktor”, për kandidatët që i kanë kryer këto studime brenda vendit, ose rezultate të mira (notë mesatare mbi 8) në studimet universitare të specializimit afatgjatë në fushën e mjekësisë dhe titulli “Doktor”, për kandidatët që i kanë kryer këto studime jashtë vendit;*

*b) së paku 7 vite punë në qendra spitalore universitare apo në spital, pas përfundimit të specializimit.*

*Përkatësia në njësitë kryesore dhe ato bazë të UMT-së përcaktohet me vendim të Senatit Akademik dhe Këshillit të Administrimit të Universitetit.*

2. Financimi i UMT-së, për vitin 2013, përbëhet nga:

a) buxheti i Universitetit të Tiranës, i planifikuar për Fakultetin e Mjekësisë dhe Fakultetin e Infermierisë;

b) burime të tjera të ligjshme.

3. UMT-së i kalojnë të gjitha asetet e luajtshme dhe të paluajtshme që zotërojnë dhe disponojnë Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Infermierisë, të Universitetit të Tiranës.

4. UMT-ja e ka selinë në Tiranë, në godinën e Fakultetit të Mjekësisë, të Universitetit të Tiranës.

5. UMT-ja e fillon veprimtarinë për vitin akademik 2012 - 2013.

6. Marrëdhëniet institucionale ndërmjet UMT-së dhe qendrave spitalore universitare e Institutit të Shëndetit Publik rregullohen sipas kuadrit ligjor në fuqi.

7. Personeli me grada shkencore dhe tituj akademikë i Institutit të Shëndetit Publik e zhvillon veprimtarinë kërkimore - shkencore dhe angazhohet në procesin e mësimdhënies në kuadër të UMT-së.

VI. Dispozitë e fundit

Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**